



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

RELACION TEKNIK

(KONTRATA NR.6)

Mirëmbajtje me performance rruga: "**Lezhë - Hoteli i Gjuetisë, K/Balldre - Bisht Jugë, Lezhë - Nënshat (Kufi me Shkodrën)**"

Përshkrim i përgjithshëm.

Aksi rrugor **“Lezhe-Hoteli i Gjuetise“ (2.9 km)** është një segment rrugor pjesë e inventarit të Drejtorisë së Rajonit Verior Shkodër. Segmenti klasifikohet i kategorisë C si rrugë interurbane dytësore , me një karrexhatë, me dy korsi lëvizjeje (nga një për çdo sens), me dy bankina ku njera është tip trotuari për lëvizje të kembespreve. Gjeresia mesatare e pjesës kaluese të rrugës është 4-5 ml. Për nga shtrirja gjeografike ky segment rrugor kalon i gjithi nëpër një terren fushor cili nuk përfshihet si segment me mirëmbajtje dimërore.

Aksi rrugor **“Nënshat (kufi me Shkodrën)-Lezhe” (21.2km)** është një segment rrugor pjesë e inventarit të Drejtorisë së Rajonit Verior Shkodër I shtuar me VKM Nr.600. . Ky segment rrugor është pjesë e aksit kryesor që lidh qytetet e Vau Dejës me Lezhë. Segmenti klasifikohet i kategorisë F si rrugë lokale , me një karrexhatë, me dy korsi lëvizjeje (nga një për çdo sens pa vije në mes), me dy bankina 50 cm të paasfaltuara. Gjeresia mesatare e pjesës kaluese të rrugës është 5 ml. Për nga shtrirja gjeografike ky segment rrugor kalon i gjithi nëpër një kodrinor dhe fushor., i cili nuk përfshihet me mirëmbajtje dimërore.

Aksi rrugor **“K/Balldre - Bisht Jugë” (19.3 km)** është një segment rrugor pjesë e inventarit të Drejtorisë së Rajonit Verior Shkodër. Ky segment rrugor është pjesë e aksit kryesor që lidh qytetet e Lezhës me aksin nacional Shkodër – Velipojë. Segmenti klasifikohet i kategorisë F dhe C si rrugë lokale dhe interurbane dytësore , me një karrexhatë, me dy korsi lëvizjeje (nga një për çdo sens pa vije në mes), me dy bankina 50 cm të paasfaltuara. Gjeresia mesatare e pjesës kaluese të rrugës është 4, 5 dhe 6 ml . Për nga shtrirja gjeografike ky segment rrugor kalon i gjithi nëpër një kodrinor dhe fushor., i cili nuk përfshihet me mirëmbajtje dimërore.

Me poshtë janë të paraqitura në formë tabelare segmente rrugore që përbejnë këto kontrate.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

Nr.	Segmenti rrugor	Gjatësia (km)	KOORDINATA E PIKES SE FILLIMIT (WGS 84)		KOORDINATA E PIKES SE MBARIMIT (WGS 84)	
			N	E	N	E
1	Lezhë - Hoteli i Gjuetisë	2.9	41°45'58.2"	19°38'06.4"	41°44'55.1"	19°36'54.9"
2	K/Balldre - Bisht Jugë (e vjetra)	19.3	41°48'59.8"	19°38'25.8"	41°55'40.0"	19°28'11.2"
3	Nënshat (kufi me Shkodrën) - Lezhë	21.2	41°55'16.5"	19°39'46.5"	41°46'58.7"	19°38'37.8"
Shuma (km):		43.4				

Kushtet e inspektimit.

Sot me datë 02.04.2024, në zbatim të Urdhërit të Brëndshëm Nr.113 datë 26.03.2024, kemi bërë inspektimin në terren të segmenteve rrugore "**Lezhë - Hoteli i Gjuetisë, K/Balldre - Bisht Jugë, Lezhë - Nënshat (Kufi me Shkodrën)**". Bazuar në urdhërin e brëndshëm për përlloraritjen e fondit limit, si objektiv i inspektimit tonë ka qënë konstatimi i gjëndjes aktuale të segmenteve rrugore në fjalë dhe përcaktimi i nevojave për punime rehabilitimi që do ketë ky segment gjatë 4 viteve të ardhshme (2025-2029) , me qëllim hartimin e preventivave për përlloraritjen e fondit limit të kontratës së ardhshme. Theksojmë se inspektimi jonë është vetëm i karakterit vizual.

Përshkrimi i situatës aktuale të segmenteve rrugore .

Gjëndja e akseve rrugore "**Lezhë - Hoteli i Gjuetisë, K/Balldre - Bisht Jugë, Lezhë - Nënshat (Kufi me Shkodrën)**" është mesatare. Gjatë zbatimit të kontratës së mëparshme të mirëmbajtjes ne segmentin "**Lezhë - Hoteli i Gjuetisë** " vihet re një ndërhyrje kryesisht në riparime të pjesshme të shtresave asfaltike. Gjithashtu evidentohen si ne kete aks ne km e par ne vendin e quajtur "mbikalimi Ishull Lezhe" sa here qe ka reshje ka grumbullim ujrash qe veshtirsojne levizjen e mjeteve.Ne kete aks jane bere nderhyrje si ne asfaltime,trotuare etj. Ne segmentet "**K/Balldre - Bisht Jugë, Lezhë - Nënshat (Kufi me Shkodrën)**" gjatë zbatimit të kontratës së mëparshme të mirëmbajtjes vihet re një ndërhyrje kryesisht në riparime të pjesshme të shtresave asfaltike. Gjithashtu evidentohen dhe riparimi i disa mureve apo kanale anesore.. Ka një përmirësim të dukshem të sinjalistikës vertikale dhe horizontale, duke shtuar edhe shumë elementë që nuk kanë qënë më përpara si shevrene apo përvijues anësorë. Gjithashtu rezulton edhe një shtim i





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

konsiderueshëm i barrierave mbrojtëse metalike krysisht në pika te rrezikshme. Por duke u nisur nga fakti se aksi rrugor kalon ne disa zona jo shume qendrushme ku vihen re cedime te shtresave te, vërehet së aksi ka nevoja të metëjshme në shtimin apo përmirësimin e të gjithë elementeve rrugore që përmendëm më sipër, pjesë të cilën do ta trajtojmë më hollësisht në pikat e mëposhtme.

Evidentimi i problematikave dhe propozimi për zgjidhjen e tyre.

- Segmenti rrugor "**Lezhë - Hoteli i Gjuetisë**" është një segment me gjatësi 2.9 km Një problematikë që vlen të përmendet është grumbullimi i ujrave ne mbikalimin Ishull Lezhe sa here qe ka reshje duke veshtirsuar levizjen e mjeteve.Ne kete vend eshte bere edhe nje devijim qe qe bene te mundur shmangejen e levizjes se mjeteve por eshte e pa asfaltuar kjo e fundit eshte domosdoshme. Gjithashtu ne kete segment shtresat asfaltike jane ne gjendje te mire.Kerkohet nderhyrje vetem ne shtimin e sinjalistikes dhe te vijeimit.

Në lidhje me vijëzimet, rezulton se nje pjes eshte vijeuar por kerkohet te permirsohet.pjesa më e madhe e aksit është momentalisht e vijëzuar ose në proces vijëzimi. Standarti i përdorur masivisht për rrugët e kategorisë C për vijëzime është : 2 vijat anësore dhe vija e mesit janë të realizuara me vijë me trashësi 15cm. Të njëjtin standart kemi ndjekur edhe në parashikimin e vijëzimeve që do realizohen katër vitet e ardhshme. Dy vijat anësore jane shumeziar me koeficient 1, ndërsa vija e mesit është shumëzuar me koeficient 0.7.

- Segmenti rrugor "**Lezhë - Nënshat (Kufi me Shkodrën)**" është një segment me gjatësi 26.8 km. Një problematikë që vlen të përmendet jane disa cedime te shtresave rrugore ne vende te caktuara si dhe amortizim ose demtim te shtresave asfaltike. Ne km 20+700 nga Vau Dejes eshte demtuar nje mur te ne anesor te ures i cili eshte parashikuar te riparohetNe lidhje me sinjalistiken mund te themi se ne pergjithesi eshte e plotesuar por ka nevojë per shtimin e saj.Gjendja e shtresave asfaltike eshte ne gjendje pothuajse mesatare ose e mire.Po keshtu edhe per vijeizimet mund te themi te njeten gje. Megjithëse ky segment rrugor ka shënja të përmirësimit të dukshëm të sinjalistikës vertikale dhe barrierave mbrojtëse metalike, përsëri kami evidentuar nevoja që do ketë aksi katër vitet e ardhshme, të cilat janë evidentuar më me saktësi në tabelat e shpërndatjes së punimeve. Në lidhje me vijëzimet, rezulton se pjesa më e madhe e aksit është momentalisht e vijëzuar ose në proces vijëzimi. Standarti i përdorur masivisht për rrugët e kategorisë C për vijëzime është : 2 vijat anësore janë të realizuara me vijë me trashësi 15cm. Të njëjtin standart kemi ndjekur edhe në parashikimin e vijëzimeve që do realizohen katër vitet e ardhshme. Dy vijat anësore jane





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

shumeziar me koeficient 1. Vendodhjet përkatëse janë të specifikuara në tabelat e shpërndarjes së volumeve. Gjatë gjithë gjatësisë së segmenteve janë parashikuar dhe riparime të tjera të vogla të mureve mbajtjes dhe pritës apo brezave të betonit, punime të cilat evidentohen në tabelat e shpërndarjes së punimeve të rehabilitimit.

● Segmenti rrugor “**K/Balldre - Bisht Jugë**” është një segment me gjatësi 19.3 km. Gjatë inspektimit kemi evidentuar disa pjesë të asfaltit kanë nevojë për riveshje apo që shfaqin shënja të dukshme të cilat mund të ndikojnë në përkeqsimin e situatës gjatë viteve të ardhshme. Vendodhjet e tyre janë të përcaktuara në tabelat e shpërndarjes së punimeve që janë plotësuar në terren. Në disa vende, aty ku është parë e nevojshme për të ruajtur konturin e asfaltit nga ujërat e skarpatit, është menduar ndërtimi i kunetave me bordurë, pozicionet e të cilave janë të përcaktuara në tabela. Megjithëse rruga është pajisur pjesërisht me sinjlistikë vertikale, përseri kemi evidentuar disa përmirësime të mëtejshme që do nevojiten gjatë 4-5 viteve të ardhshme. Është menduar dhe një shtim të sasisë së guardrailave pasi ka zona ku është e domosdoshme vendosja e tyre, pasi edhe guarderelat ekzistuese janë të demtuara. Vendodhja e tyre është përcaktuar në tabelën e shpërndarjes së punimeve të rehabilitimit.

Parashikimi i punimeve të rehabilitimit.

Për të lehtësuar mënyrën e paraqitjes së shpërndarjes së punimeve të rehabilitimit, kemi menduar që sasi të këtyre punimeve të paraqesim fragmentuara dhe të grupuara në segmente prej 1 kilometri. Përzgjedhja e zërave të punimeve të rehabilitimit është bërë në bazën e eksperiencës që kemi në kontratat e mëparshme duke evidentuar zërat që kanë rezultuar me efektivitet më të lartë gjatë kontratave të shkuara, si dhe shtimin e disa zërave të rinj të cilët na kanë rezultuar të duhur për përdorim në situata të caktuara.

Volumet e punimeve të parashikuara për një periudhë 4 vjeçare sipas segmenteve respektive, janë paraqitur në tabelat e shpërndarjes së punimeve të rehabilitimit periodike.

Tabela përmbledhëse e kategorisë së punimeve të rehabilitimit është :

Nr.Ana	Përshkrimi i punimit	Njesia	Sasia
	1. PUNIME GERMIMI		





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

3.119/a	Germim shkemb i coptuar me ekskavator 0.5 m ³ , shkemb, ne themele gjeresi ~2 m, me shkarkim ne toke,	m3	660
3.95/b	Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke	m3	50
3.158/3a	Transport dheu me auto deri 3.0 km	m3	120
3.161/2	Rrafshim skarpate ne germim, ekskavator 0.25m ³	m2	200
2. PUNIME SHITESASH			
3. 197	Prishje shtrese çakelli t = 10 cm, me makineri	m2	1200
3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm	m2	800
3.212/c	Shtrese stabilizant t=15cm	m2	800
3.212/d	Shtrese stabilizant t=20cm	m2	1500
3.969	Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri	m2	5950
3.164/1a	Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	m3	75
3. ANALIZA TEKNIKE			
3.222/2	Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri	m2	5950
3.226/1	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri	m2	5950
4. PUNIME BETONI E BETONARMEJE			
3. 244	Struktura monolite betoni C 20/25	m3	375
3. 235	Struktura monolite b/betoni C 12/15 me 20% gur	m3	20
5. PUNIME HEKUR BETONI 3			



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

3. 287	F V hekur betoni i zakonshem \varnothing 6 ~ 10mm	ton	0.1
3. 288	F V hekur betoni i zakonshem \varnothing > 12mm	ton	0.1
	6. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT +KANALIZIME		
3. 323	Mur guri mbajtes e themele, llaç çimento M50	m3	25
3. 396	Mbushje me cakell pas mureve	m3	180
3. 332	Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x1.5 m	m3	35
3. 405	Prishje struktura prej guri	m3	25
3. 366	Tombino me tuba betoni \varnothing 800, mbi shtrese betoni	ml	12
	7. PUNIME TE NDRYSHME		
3. 618	FV Bordura betoni 20x35 cm	ml	80
	8. D. SINJALET DHE PAJISJET SHTESE, NGADALSUESIT E SHPEJTESISE		
3.948/1	F.v.kurrize artificiale h =5cm	copë	24
3.949/1	Vizime me boje bikomponente me gjeresi 15 cm	ml	8020
3. 953	FV tabela rrugore treguese 150x40cm	copë	22
3. 955	FV tabela te ndryshme rrugore D=60cm	copë	24
	11. TE NDRYSHME ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA		
3.921/1	F.v. Tabele katrore normal me A=60	copë	18
3.936/1	F.v. Tabela trekendore normal me A = 90	copë	42
3.935/1	F.v. Tabele rrethi "ndalim" normal me D = 60	copë	26
3.933/1	F.v. Tabela tetekendore normal me A-B, 90-30	copë	14



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

3.941/1	F.v. Pervijues normal anesor	copë	210
3.941/3	F.v. Pervijues modulare te kthesave (teke)	copë	68
3.941/4	F.v. Pervijues modulare te kthesave (qyfte)	copë	48
3.941/5	F.v. Pervijues kthese e ngushte ose e forte(ne forme T)	copë	26
3.186	F.V guardrail- H1 anesore me 2 valz.e ne 1 ane , W3	ml	60
3. 165	Fuge me gome speciale me kanal te gjere ne ura	ml	14

Foto nga inspektimi në terren.

Gjatë inspektimit në terren janë fotografuar dhe disa nga problematikat aktuale të akseve rrugore. Bashkangjitur janë fotot e realizuara në terren dhe tabelat e shperndarjes se punimeve rehabilituse periodike:





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR





REPUBLIKA E SHQIPËRIË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR





REPUBLIKA E SHQIPËRIË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR



GRUPI I PUNËS :

